



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njëri anë;

Dhe

"SHKËMBI" SHPK nga Istogu, të cilën e përfaqëson z. Musa Metaj, me Nr. Rexh. Biznesi, 810296039 (në vazhdim "Kontraktuesit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDËRTIMI I RRUGËS LLUGA – LAGJA "BALAJ –Llot 1

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-20-1380-5-2-1/ C333- LOT 1</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 020 / 015/ 521</i>

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDËRTIMI I RRUGËS LLUGA – LAGJA "BALAJ –Llot 1

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi I kontrtës per aktivitetin e prokurimit **NDËRTIMI I RRUGËS LLUGA – LAGJA “BALAJ –Llot 1 është 31.639,20 dhe me fjalë euro.**

me shkronja: Tridhjetëenjëmijegjashtëçindetrdhjetëenëntëeuro20/100 €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit te kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për


pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktuesin:
"Shkëmbi" Shpk

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Musa Metaj
Pozita:	Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.06.2020	Data:	29.06.2020
Vu la		Vu la	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës në afat prej 3 MUAJ</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do të jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe të gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve në vend punishte janë në përgjegjësi të Operatorit ekonomik deri në shumën e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do të jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 2 MUAJ
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <i>0.25%</i> për ditë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është <i>1 vite</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do të provojnë në mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do të organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kanë efekt atëherë kompetente do të jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë

ASFALTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN LLUGA - KOMUNA E ISTOGUT					
I. ASFALTIMI I "RRUGËVE ME GJERËSI b=4.0m L = 260 m dhe (Krahu 2) b=3.0m L = 570 m "					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
GJATËSIA E RRUGËS L=(m'):		830	GJERËSIA b=(m'):		4 dh 3
		GJERËSIA E GËRMIMIT b=(m'):		5 dhe 4	
Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN				1,660.0 €
1.1	Mobilizimi i ndermarjes dhe rregullimi i punishtes per pune si dhe largimi i instalimeve te ndryshme (elektrike, uji dhe kanalizimi, ptk, kabllorike etj) ne punishte ne rast se ka ne ato hapësira dhe dislokimi i tyre ne vendet e caktuara nga institucionet perkatese. Te gjitha angazhimet dhe shpenzimet per dislokimin dhe rikyqjen e instalimeve ne rrjetin te qytetit i bart operatori ekonomik.	m'	830.00	0.50 €	415.00 €
1.2	Vendosja e shenjave te perkohshme vertikale dhe shenjave per kontrole te trafikut gjate kryerjes se punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjate punimeve.	m'	830.00	0.50 €	415.00 €
1.3	Shenimi i trasese si dhe percjellja e punimeve me matje gjeodezike gjate egzekutimit.	m'	830.00	0.50 €	415.00 €
1.4	Pastrimi i terenit ne pjeset anesore te ruges ne te dyja anet e saj nga shkuret, rrenjet e drunjeve egzistues si dhe ndonje pengese eventuale (gardhet) etj.	m'	830.00	0.50 €	415.00 €
2	PUNËT TOKËSORE				2,808.2 €
2.1	Gërmimi i dheut te kategoris se III dhe IV me trashesi t=25cm , dhe bartja e materialit te germuar deri ne deponi me te afert.	m3	895.00	1.00 €	895.00 €
2.2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazes se rruges në tërë gjatësin e saj me saktësi deri ne 2cm me grejder me modul te ngjeshjes 30-35MPa.	m2	3,544.00	0.30 €	1,063.20 €
2.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave prej betoni fi , 1000/1000mm sipas nevoje ne teren per punimin e lesheses. Ne kete position llogariten edhe kokat hyrse dhe dalese. Vendosja e armatures rrjete Q-378 (Φ8.5/15/15) si dhe furnizimi dhe vendosja e betonit te lesheses, (pllake mbi tubacion b=1.0m dhe t=10cm) qe e trupon rrugen me beton te klases C-30/37.	m'	8.00	50.00 €	400.00 €
2.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave prej betoni fi 600/1000mm, sipas nevoje ne teren per punimin e lesheses. Ne kete position llogariten edhe kokat hyrse dhe dalese. Vendosja e armatures rrjete Q-378 (Φ8.5/15/15) si dhe furnizimi dhe vendosja e betonit te lesheses, (pllake mbi tubacion b=1.0m dhe t=10cm) qe e trupon rrugen me beton te klases C-30/37.	m'	15.00	30.00	450.00
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS				27,171.0 €
3.1	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granular nga guri i thyer (0-63mm) me trashesi pas ngjeshjes t=20 cm , ngjeshja te behet me cilinder 25tone deri ne moduln e ngjeshjes 50-60Mpa.	m3	720.00	8.00 €	5,760.00 €

Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
3.2	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushës zhavorik të granulluar nga guri i thyer (0-31.5mm) me trashësi pas ngjeshjes t=10cm, ngjeshja të bëhet me cilindër 25tone deri në modulën e ngjeshjes 80Mpa.	m ³	358.00	6.00 €	2,148.00 €
3.3	Matja e modulit të ngjeshmerisë së trases së rrugës para shtruarjes së asfaltit nga një laborator të caktuar nga autoriteti kontraktues (menagjeri i projektit) në vendet e caktuara poashtu nga menagjeri i projektit. Në rast se dalin rezultatet në kundërshtim me pikën (3.2) të parametres d.m.th. 80MPa duhet të bëhet perseritja e matjeve të ngjeshmerisë por në këtë rast shpenzimet për rimatje të barte operatori ekonomik. Në këtë pozicion përfshihet edhe matja e trashësisë së shtresave të tamponit.	copë	7.00	50.00 €	350.00 €
3.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së asfaltit me asfaltbeton AB-16, me trashësi 7cm pas ngjeshjes adekuate. Karakteristikat e asfaltit: fraksionet e asfaltit >2mm...45-82.5%, fraksionet e agregatit <2mm...27-49%, pjesa për mbushjen e poreve <0.09mm...3-6%, përqindja e fllerit ndaj agregatit 4-10%, materiali lidhës - bitumen B50/70...5.3-6.5% dhe shkalla e ngjeshjes >97%. Garancioni i qëndrueshmërisë së asfaltit duhet të jetë minimum 5 vjeçar prej ditës kur është bërë pranimi teknik i punimeve.	m ²	2,792.00	6.50 €	18,148.00 €
3.5	Marja e mostrave të asfaltit për shqyrtim nga një laborator të caktuar nga autoriteti kontraktues (menagjeri i projektit) në vendet e caktuara poashtu nga menagjeri i projektit.	copë	7.00	50.00 €	350.00 €
3.6	Furnizimi me material, transporti dhe shtruarja e bankinave në dy anët e rrugës me gjerësi nga 0.5m me trashësi 8cm pas ngjeshjes nga guri i thyer me fraksion (16-31.5mm).	m'	830.00	0.50 €	415.00 €

I. REKAPITULIMI

1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN	1,660.0 €
2	PUNËT TOKËSORE	2,808.2 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS	27,171.0 €
I. TOTALI (1+2+3):		31,639.20 €